



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Skenderaj Municipal

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Department of Finance and budget
Direkcija za finansije i bužet

NJOFTIM PUBLIK

Lëshimin e Faturës, Mënyra e Pagesës dhe Afati i Pagesës së Tatimit në Pronë

Komuna Skenderaj, njofton tatimpaguesit që janë të regjistruar në sistemin e tatimit në pronë me numër personal të Republikës së Kosovës se mund të bëhet lëshimi i faturës së tatimit në pronë drejtpërdrejt në platformën e-Kosova në linkun <https://ekosova.rks-gov.net/> ose duke u paraqitur personalisht në komunën ku edhe janë pronarë/e ose posedues/e të pronës së paluajtshme.

Pagesa e Tatimit në Pronë mund të bëhet në:

- Në ndonjë nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
- Përmes E-Banking.
- Përmes platformës e-Kosova.
- Në të gjitha institucionet të licencuara në Kosovë.
- Nëse nuk jetoni në Kosovë, shfrytëzoni alternativa tjera të pagesës.

Gjithashtu rikujtojmë të gjithë tatimpaguesit që nuk e kanë bërë pagesën e tatimit në pronë, që pagesën ta bëni me kohë, që të shmangni llogaritjen e interesit dhe gjobës.

Sipas vendimit: 03/2026 dt.29.01.2026 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve shtyhen **afatet kohore** dhe atë:

1. Afati për lëshimin e faturave të tatimit në pronë shtyhet deri më **31 Mars 2026**.
2. Afati për pagesën e këstit të parë të detyrimeve të tatimit në pronë shtyhet deri më **30 Qershor 2026**

Nëse pagesa nuk paguhet sipas afateve si më lartë pason llogaritja e gjobës dhe interesit si në vijim:

- Në shumën e tatimit të secilit këst të pa paguar llogaritet një gjobë prej **10%**.
- Në shumën e tatimit të secilit këst të pa paguar llogaritet interesi në baza mujore prej **0.65%**.

z. Behxhet Maliqi

Drejtori për Buxhet dhe Financa,

Komuna e Skenderajt

